

20.02.2022  
Ora 14:23

**RENDI I DITËS**

Projektvendimi: “Për miratimin e llojit të të dhënave që transmetohen nga pajisja elektronike e identifikimit drejt infrastrukturës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) të KOZ dhe rregullat për mënyrën e transmetimit të tyre”.

**PJESËMARRJA :**


**KQZ:**

• **Komisioni Rregullator:**

- |            |           |                    |
|------------|-----------|--------------------|
| • Ilirjana | NANO      | Kryetar            |
| • Arens    | ÇELA      | Anëtar             |
| • Dritan   | ÇAKA      | Anëtar             |
| • Helga    | VUKAJ     | Anëtar             |
| • Muharrem | ÇAKAJ     | Anëtar             |
| • Stafi    | KQZ       | Y. Merkaj, M. Koja |
| Parti      | Politike: | S’ka prezent       |
| Të         | tjerë:    | KRIIK              |

**Znj. I. Nano:** Mirëdita! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për ditën e sotme datë 20 shkurt 2023. Në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator, Sekretari i Përgjithshëm i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe zyrtarë të tjerë të administratës së KQZ-së. Në mbledhjen e sotme kemi një projektakt për të diskutuar për miratimin e llojit të të dhënave që transmetohen nga pajisja elektronike e identifikimit drejt infrastrukturës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) të KQZ-së dhe rregullat për mënyrën e transmetimit të tyre. Projektakti ka ardhur me iniciativë të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, z. Celibashi dhe Nënkomisioneres

Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI

P 

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.20.02.2023*

Shtetërore të Zgjedhjeve znj. Pelinku. Para se të fillojmë me shqyrtimin e projektaktit doja të pyesja kolegët nëse kanë diçka për të diskutuar jashtë rendit të ditës. Kolegë? Nëse jo fillojmë me projektaktin që kemi sot në rendin e ditës. Do t'i lutesha Sekretarit të Përgjithshëm të prezantonte shkurtimisht projektaktin dhe relacionin shpjegues. Zoti Merkaj!

**Z. Y. Merkaj:** Faleminderit! Neni 20 dhe 22 i Kodit Zgjedhor parashikon kompetencën e Komisionit Rregullator për të shqyrtuar dhe miratuar aktet me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e KQZ-së ose nga anëtarët e tij, për përdorimin e sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit për mbulimin e aspekteve apo procedurave të veçanta të procesit zgjedhor, ose heqjen e tyre nga përdorimi. Me vendimin nr. 2 datë 31.10.2020 Komisioni Rregullator ka miratuar llojet dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e identifikimit elektronik të zgjedhësve që përdorin zgjedhësit në Republikën e Shqipërisë për te përshtatur nga pikëpamja teknike Pajisjen Elektronike të Identifikimit (PEI) me qëllim transmetimin e të dhënave statistikore në mënyrë të sigurt dhe pa cenuar integritetin e informacionit të transmetuar, është përgatitur projektakti i mësipërm. Me vendimin nr. 5 datë 10.2.2023 Komisioni Rregullator ka miratuar nga një përshtatje teknike të pajisjes (PEI) nëpërmjet një modemi USB dhe kartës SIM Kjo përshtatje teknike mundëson transmetimin e të dhënave statistikore nga pajisja PEI drejt TIK-ut të KQZ-së dhe jo anasjelltas, e më pas drejt dashboardit, i cili do të aksesohet vetëm nga stafi i autorizuar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për të monitoruar te dhënat. Transmetimi i të dhënave në këtë mënyrë rrit saktësinë në marrjen e informacionit dhe garanton atë në kohë më të shpejt. PEI-t janë pajisje të sigurta që mundësojnë identifikimin elektronik duke e ruajtur informacionin në memorie fizike të veçantë, të cilat në përfundim të procesit qendërzohen në Sistemin

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.20.02.2023*

Elektronik të Identifikimit të Votuesve e nga ku nxirret informacioni i saktë në lidhje me pjesëmarrjen e votuesve. Të dhënat që do të transmetoj janë:

Numrin e pajisjes së konfiguruar,

Numrin e PEI ku procesi i identifikimi është hapur,

Numrin e PEI ku procesi identifikimi është mbyllur,

Numrin e votuesve që janë identifikuar,

Numrin e votuesve sipas gjinisë (femra/meshkuj),

Numrin e votuesve për herë të parë,

Numrin e votuesve sipas grupmoshës (18-24, 25-34, 35-44, 45-54, 55-64, 65+),

Numrin e votuesve të identifikuar me shenja gishtash,

Numrin e votuesve të identifikuar pa shenja gishtash,

Numrin e votuesve të veçantë,

Numrin e votuesve me vendim gjykatë,

Numrin e votuesve të verifikuar në qendrën e votimit të gabuar (zgjedhës të cilit dokumenti i identifikimit i është skanuar nga PEI dhe nga skanimi rezulton se ai votues duhet të paraqitet në një tjetër qendër votimi),

Numrin e tentativave të dyfishta të identifikimit.

Të dhënat e gjeneruara nga PEI si rrjedhojë e identifikimit të zgjedhësve, do të transmetohen nëpërmjet një USB-je, me kartë SIM, i cili vendoset në një nga portat e USB-së të pajisjes PEI. Modemi USB do të konfigurohet në mjediset e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve vetëm nga një staf i këtij të fundit gjatë procesit të përgatitjes së pajisjeve të identifikimit elektronik. Kapaku i folesë ku vendoset modemi duhet të jetë vulosur fizikisht me një kod sigurie nga stafi i KQZ-së. Numrat serial të kodeve mbahen shënim në procesverbal në dërgim dhe kontrollohen në kthim nga stafi i Komisioni Qendror I Zgjedhjeve për të vërtetuar paprekshmërinë e pajisjes. Siguria e informacionit zbatohet nëpërmjet certifikatave dhe çelësave të enkriptuar. Transmetimi i të dhënave ndodh me frekuencë orare periodike. Transmetimi, në varësi edhe të shpejtësisë së internetit,

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.20.02.2023*

parashikohet të marrë vetëm disa sekonda kohë. Pra, pajisja është e lidhur me internetin, në një kah vetëm në intervalin kohor të transmetimit. Informacioni do të transmetohet nga PEI në TIK të KQZ-së, ku akses do të kenë vetëm stafi i KQZ-së. Garancitë lidhur me sigurinë e informacionit: Informacioni është një transmetim vetëm me një kah, (vetëm në kahun hyrës dhe jo në kahun dalës), pra kemi vetëm dalje të informacionit nga pajisja. Për më tepër, metoda e menaxhimit të informacionit në pajisje është vetëm lexim, pra është e pamundur të modifikohet informacioni në pajisje, me fjalë të tjera të manipulohen të dhënat në të. Pajisja është ndërtuar në mënyrë të tillë që i gjithë informacioni pritisë është I bllokuar. Portat logjike hyrëse janë të mbyllura. Informacioni i transmetuar do të përfshijë vetëm të dhënat e përcaktuara në këtë projektvendim. Disponimi i informacionit me frekuence çdo një-orë për pjesëmarrjen së zgjedhësve në mënyrë më të saktë, të plotë dhe të shpejt në rang vendi, në raport me metodën klasike të kampionimit të përdorur deri më sot nga KQZ-ja, përbëjnë një avantazh të cilin e kemi parashikuar për këtë projektvendim. Mbas kësaj vjen porojetvendimi për shqyrtim dhe miratim. Faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Faleminderit z. Merkaj! Sikundër dhe ju e theksuat ne pak ditë më parë kemi miratuar një vendim për ndryshimin në vendimin për karakteristikat teknike të PEI ku kemi autorizuar dhënien e informacionit me një drejtim nga PEI drejt infrastrukturës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në KQZ, dhe madje në atë vendim kemi dhe autorizimin për miratimin e të dhënave që do transmetohen dhe rregullat e tyre. Rregullat e transmetimit. Atëhere fillojmë diskutimin në parim. Kolegë kemi diçka për projektaktin? Nëse jo kalojmë në votimin në parim të projektvendimit.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (zgj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj.Vukaj, z. Çakaj)

**Kundra:** S'ka

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.20.02.2023*

Me 5 vota pro, miratohet!

Kalojmë pikë për pikë. Me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Nënkomisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator vendosi:

1. Të dhënat që do të transmetohen gjatë ditës së zgjedhjeve nga pajisja elektronike e identifikimit (PEI) drejt infrastrukturës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) të KQZ përfshijnë:

- a) Numrin e pajisjeve të konfiguruar,
- b) Numrin e PEI ku procesi i identifikimit është hapur,
- c) Numrin e PEI ku procesi i identifikimit është mbyllur,
- d) Numrin e votuesve që janë identifikuar,
- e) Numrin e votuesve sipas gjinisë (femra/meshkuj),
- f) Numrin e votuesve për herë të parë (18+) vjeç,
- g) Numrin e votuesve sipas grupmoshës (18-24, 25-34, 35-44, 45-54, 55-64, 65+),
- h) Numrin e votuesve të identifikuar me shenja gishtërinjsh,
- i) Numrin e votuesve të identifikuar pa shenja gishtërinjsh,
- j) Numrin e votuesve të veçantë,
- k) Numrin e votuesve me vendim gjykate,
- l) Numrin e votuesve të verifikuar në qendrën e votimit të gabuar me sqarimin (zgjedhës apo votues të cilit dokumenti i identifikimit i është skanuar nga PEI dhe nga skanimi rezulton se ai votues duhet të paraqitet në një tjetër qendër votimi),
- m) Numrin e tentativave të dyfishta të identifikimit.

Kolegë për pikën 1 të projektvendimit, znj. Vukaj!

**Znj. H. Vukaj:** Parimisht jam dakord me pikën një dhe aq sa lexuat ju apo sa ka ardhur në këtë projektakt. Do të preferoja meqënëse vendosëm përjashtimin nga rregulli klasik do të preferoja që të ishte më imperative, pra të dhënat që do të transferohen të shoqëroheshin jo me shprehjen “do të” por “të dhënat që duhet të

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.20.02.2023*

transferohen” do t’i rrinte më mirë kësaj pike dhe në të njëjtën kohë do krijonte urdhërim për kufijtë apo për tablonë që kemi krijuar në lidhje me llojin e të dhënave që do të transferohen. Në daç konsideroheni propozim, në daç një zëvendësim gjuhësor, si të dëshironi.

**Znj. I. Nano:** Ose duhet një harmonizim me titullin e projektvendimit që të keni të njëjtën terminologji pastaj.

**Znj. H. Vukaj:** Nöso i rri më mirë patjetër, pse jo?

**Znj. I. Nano:** Atëhere t’ja lëmë administratës gjatë zbardhjes këtë çështje, harmonizimin e titullit madje dhe harmonizimin me vendimin e miratuar datë 10 shkurt. Pra aty ku kemi autorizimin konkret për miratimin e këtij akti të kemi të njëjtën gjuhë, terminologji në aktet e tjera. Pra ta lëmë me harmonizim, jo propozim për ndryshim por harmonizim të gjuhës së përdorur. Atëhere votojmë pikën një , nëse nuk keni propozime!

**Kush është dakord kolegë?**

**Pro:** 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundra:** S’ka

Me 5 vota pro, miratohet!

2. Të dhënat e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, do të transmetohen nëpërmjet një modemi USB, me kartë SIM, i cili vendoset në një nga portat USB të PEI. Kemi kohë zonja Vukaj?

**Znj. H. Vukaj:** Para se të kalojmë në votim doja të dija nga administrata në ç’mënyrë zgjidhet karta SIM dhe çfarë siguri ka që nga a-ja pra vendosja, që nga hapi i parë e deri te hapi i fundit. Në lidhje me pikën dy gjithmonë.

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.20.02.2023*

**Z. E. Dushollari:** Modemi dhe karta SIM prokurohen në mënyra të ndryshme, pra nuk ka një lidhje direkte nëpërmjet prokuruesit të kartës SIM dhe modemit. Proçesi asibimit të dy komponentëve ndodh në ambjentet e KQZ-së gjatë proçesit të përgatitjes së pajisjes elektronike të identifikimit. Ka një rend të paktën në zgjedhjet e shkuara ka një rend në proçedurë se si përgatitet pajisja nga pika a deri në pikën zh. Duke qënë se kemi një ndryshim, ndryshimin që po diskutojmë, do të shtohet një pikë në proçedurën e përgatitjes që do të jetë asibimit dhe instalimi le të themi i modemit në USB. Gjithë proçesi ndodh rëndom pra merret modemi i parë që kap specialisti.

**Znj. H. Vukaj:** Specialisti keni parasysh personin përgjegjës, i autorizuar për këtë proces

**Z. E. Dushollari:** Po flasim për person përgjegjës të autorizuar, staf i KQZ-së

**Znj. H. Vukaj:** Pra po ta shqipërojmë rendum për publikun dhe gjithë ato që na ndjekin ndoshta është përzgjedhje rastësore

**Z. E. Dushollari:** Po përzgjedhje rastësore patjetër.

**Znj. H. Vukaj:** Si SIM si modemi?

**Z. E. Dushollari:** Të dyja.

**Znj. H. Vukaj:** Dakord! Kjo jep garanci deri në fund hapave të proçesit.

**Z. E. Dushollari:** Nga fillimi procesit deri në fund.

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.20.02.2023*

**Znj. I. Nano:** Dakord kolegë! Ndonjë pyetje, ndonjë diskutim lidhur me pikën dy? Nëse jo kalojmë në votimin e pikës dy.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (zgj.Nano, z. Çela, z. Çaka, zgj.Vukaj, z. Çakaj)

**Kundra:** S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

3. Modemi USB konfigurohet në mjediset e KQZ-së vetëm nga stafi i këtij të fundit gjatë procesit të përgatitjes së PEI. Mesa duket dhe kjo u sqarua nga specialist përkatës. Kolegë koni diçka me pikën tre? Kalojmë në votim.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (zgj.Nano, z. Çela, z. Çaka, zgj.Vukaj, z. Çakaj)

**Kundra:** S'ka

Miratohet!

4. Kapaku i folesë ku vendoset modemi duhet te vuloset fizikisht me kode sigurie nga stafi i KQZ-së. Numrat serial të kodeve të sigurisë mbahen shënim në procesverbal në momentin e dërgimit të PEI dhe kontrollohen në kthim nga stafi i KQZ-së për të vërtetuar paprekshmërinë. Ndonjë pyetje apo sqarim, diskutim? Jo? Kalojmë në votimin e pikës katër.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (zgj.Nano, z. Çela, z. Çaka, zgj.Vukaj, z. Çakaj)

**Kundra:** S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

5. Siguria e informacionit zbatohet nëpërmjet certifikatave dhe çelësave të enkriptuar.

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt 20.02.2023*

**Znj. I. Nano:** Kolegë kemi diçka me pikën 3? Kalojmë në votim!

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5(znj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj.Vukaj, z. Çakaj)

**Kundra** S'ka

**Me pesë vota pro, miratohet!**

4- Kapaku i folesë ku vendoset modemi duhet të vuloset fizikisht me kode sigurie nga stafi i KQZ-së. Numrat serial të kodeve të sigurisë mbahen shënim në procesverbal në momentin e dërgimit të PEI dhe kontrollohen nga stafi i KQZ-së për të vërtetuar paprekshmërinë. Ndonjë pyetje apo sqarim? Diskutim? Jo!

Kalojmë në votimin e pikës 4.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5(znj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj.Vukaj, z. Çakaj)

**Kundra** S'ka

**Me pesë vota pro, miratohet!**

5- Siguria e informacionit zbatohet nëpërmjet çertifikatave dhe çelsave të inkriptuar. Kemi diçka? Jo!

Kalojmë në votim!

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5(znj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj.Vukaj, z. Çakaj)

**Kundra** S'ka

**Me pesë vota pro, miratohet pika 5!**

6- Transmetimi i të dhënave ndodh me frekuencë orare periodike. Nëse mundet dikush nga administrata, kur flasim për frekuencë orare periodike është menduar do të rregullohet me akte të mëtejshme, me akte proceduriale që ka Komisioneri dhe Nënkomisionerja? Po zoti Çakaj?!

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së*

*Komisionit Rregullator*

*Dt 20.02.2023*

**Z. M. Çakaj:** Unë mendoj se, duke qenë se Komisioni Rregullator miraton rregulla, procedura, karakteristika teknike në mënyrë që ti lëm edhe hapësirë dukeqenëse ky akt do të zbatohet nga administrata e KQZ-së por edhe nga Komisioneri dhe Nënkomisionerja ne miratojmë rregullin. Pra, lloji i transmetimit do të jetë me frekuenca periodike por se është orare çdo 2 orë, çdo gjysëm ore le ta kenë lirshmërinë në varësi edhe të mënyrës si do ta procesojnë në praktikë. Kështu që propozimi im konkret për këtë pikë është që të hiqet fjala orare. Pra “transmetimi i të dhënave ndodh me frekuencë periodike” dhe në varësi të mënyrës se si do ta zgjidhin në praktikë ta përcaktojnë me akt të përbashkët Komisioneri, Nënkomisionerja.

**Znj. I. Nano:** Kanë në fakt ato akte që miratojnë rregulla të detajuara dhe proceduriale dhe operationale. Pra, për propozuesit tani, togfjalëshi “frekuencë orare periodike” ka nënkuptuar çdo 1 orë?

**Z. E. Dushallari:** Po, çdo 1 orë.

**Z. Y. Merkaç:** Jo vetem çdo 1 orë por dhe në fillim të hapjes së votimit do i pransmetojë numrin e pajisjes edhe është hapur apo jo votimi.

**Znj. I. Nano:** Është miratuar me akt të Rregullatorit çfarë transmeton, çfarë raporti ka PEI, çfarë printon PEI në momentin e hapjes. Pra, raporti i hapjes dhe i mbylljes është tashmë i miratuar. Flasim për këto të dhëna që miratojmë sot dhe transmetimin e tyre.

*Zbardhi materialin audio*

*Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt 20.02.2023*

**Z. M. Çakaj:** Nëse biem dakort në fillim për periodikun pastaj se sa periodeke, se sa duhet të jetë frekuenca e caktojmë. Pra, unë besoj se kjo e ndihmon më shumë edhe procesin, edhe administratën i jep një lirshmëri në pjesën e zbatimit praktik.

**Znj. I. Nano:** Atëherë unë edhe njëherë do doja të qartësohesha për vete, kur themi “frekuencë orare periodeke” kemi nënkuptuar çdo 1 orë. Dhe propozimi i zotit Çakaj është të mos e përcaktojmë këtu por e përcaktojmë më vonë në aktët që... Pra, me “frekuencë periodeke” të hiqet fjala orare. Kemi një propozim kolegë!

***Kush është dakord me propozimin e zotit Çakaj?***

**Pro:** 5(znj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj.Vukaj, z. Çakaj)

**Kundra** S'ka

***Me pesë vota pro, miratohet!***

7- Informacioni që do të transmetohet nga PEI drejt TIK të KQZ-së aksesohet vetëm nga stafi i KQZ-së. Kalojmë në votim!

***Kush është dakord?***

**Pro:** 5(znj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj.Vukaj, z. Çakaj)

**Kundra** S'ka

***Me pesë vota pro, miratohet!***

8- Ngarkohet administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

***Kush është dakord?***


**Pro:** 5(znj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj.Vukaj, z. Çakaj)

**Kundra** S'ka

***Me pesë vota pro, miratohet!***

9- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt 20.02.2023*

***Kush është dakord?***

***Pro:*** 5(znj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj.Vukaj, z. Çakaj)

***Kundra*** S'ka

***Me pesë vota pro, miratohet!***

10-Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

***Kush është dakord?***

***Pro:*** 5(znj.Nano, z.Çela, z. Çaka, znj.Vukaj, z. Çakaj)

***Kundra*** S'ka

***Miratohet!***

Kalojmë në votimin në tërësi të projektaktit, edhe njëherë vullnetin tuaj kolegë lidhur me projektaktin.

***Kush është dakord?***

***Pro:*** 5(znj.Nano, z.Çela, z. Çaka, znj.Vukaj, z. Çakaj)

***Kundra*** S'ka

***Miratohet me pesë vota pro!***

Meqë nuk kemi akt tjetër në rendin e ditës, as çështje tjetër të rendit të ditës për të... ka diçka zonja Vukaj? Ndjesë! Pyeta në fillim të mbledhjes...

***Zj. H. Vukaj:*** Jo nuk kam ndonjë çështje konkrete jashtë rendit të ditës por thjesht pyetje drejtuar administratës. Dy rende më parë kam ngritur një çështje për fenomenin “Aktivisti” i cili pasvijon pas atij “Patronazhisti”. Meqenëse është një problem shumë i madh për procesin e votimit, procesit në tërësinë e votës me të gjithë elementët e saj, do të kërkoj edhe njëherë nga administrata se çfarë është bërë në lidhje me kërkesat e mija lidhur me institucionet ligjzbatuese.

***Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI***



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt 20.02.2023*

**Z. Y. Merhaj:** Ne e transmetuam kërkesën tuaj Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe kemi rënë dakord që do të bëjmë 4 shkresa drejtuar në 4 institucione të ndryshme: Sigurimet Shoqërore, Degës së Thesarit, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit si dhe Prokurorisë së Përgjithshme. Jemi duke i përgatitur shkresat dhe shumë shpejt do ti nisim. Faleminderit.

**Z. M. Çakaj:** Edhe njëherë të lutem, kujt i keni bërë shkresa?


**Z. Y. Merhaj:** Degës së Thesarit, Sigurimet Shoqërore, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit si dhe Prokurorisë së Përgjithshme.

**Z. M. Çakaj:** Po Departamentit të Administratës Publike ose nëpunësit civil?

**Z. Y. Merhaj:** Nuk i kemi bërë, do ta shtojme si...

**Z. M. Çakaj:** Kisha dhe unë një pyetje, siç jemi të gjithë në dijeni ne kemi një ndërfaqe për raportimin qoftë të veprimtarive të kaluara dhe qofte edhe kerkesave, ankesave të ndryshme çfarë mund të kenë jo vetëm palët por edhe punonjës të shërbimit civil dhe jocivil pra, punonjës të administratës shtetërore. A ka deri më tani me dijeninë tuaj ndonjë ankesë lidhur me detyrime të ndryshme, lidhur me intimidimin, lidhur me shqetësime, lidhur me në orar të punës ose jashtë orarit të punës nga punonjës të administratës shtetërore për këtë aplikacion? Unë nuk besoj zoti Sekretar i Përgjithshëm, se ju dëgjova me vëmendje rradhën e kaluar dhe nuk besoj se ju vërtet nuk e keni dëgjuar këtë aplikacion “Aktivisti” dhe vërtet e besoni

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt 20.02.2023*

atë që të paktën deklaruar përpara nesh se nuk ka intimidime. Në jetojmë në Shqipëri, sigurisht që e shohim në mos e ndjejmë nga televizioni, nga media online. Ne e shohim pasi gjithësecili nga ne ka njerëz të punësuar në administratë. E shohim në mënyrë të përditshme se si, se çfarë ndodh, se si mundohet në një formë ose në një tjetër të intimidohen apo të detyrohen punonjësit e administratës. Ajo çfarë po ju pyes drejtëpërdrejt, a ka ndonjë raportim, ose shqetësim në ndërfaqen e KQZ-së, lidhur me këtë aplikacion ose me detyrime të tjera?

**Z. Y. Merkaç:** Deri tani në dijeninë time, pasi jam dhe unë pjesë e këtij emaili që është për denoncim te portali, nuk ka asnjë denoncim.

**Z. M. Çakaj:** Mund ti bëni edhe një kërkesë krahas atyre 4 kërkesave që kishit menduar ju si administratë, mund ti bëni edhe një kërkesë DAP-it, lidhur me nëpunësit civilë?

**Z. Y. Merkaç:** Patjetër.

**Z. M. Çakaj:** Mirë, faleminderit!

**Zj. H. Vukaj:** Edhe diçka tjetër në kërkesën drejtuar prokurorisë apo organe të tjera ligjzbatuese do doja të di, se ne ç'fazë janë kallzimet penale të bëra nga KQZ-ja në lidhje me personat të cilët kanë ndërhyrë për të manipuluar apo tjetërsuar votën në zgjedhjet e kaluara. Sepse rast tipik i këtij ndoshta mosreagimi ishte rasti i drejtoreshës së AKSHI-t e cila për rastësinë e saj negative por dhe tonën rezultonte që kishte ndërhyrë në procesin e numërimit të votave dhe kishte kallëzim nga ana e KQZ-së. A mund të pyesim prokurorinë se në ç'fazë janë me kallëzimet e bëra nga

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt 20.02.2023*

ne si KQZ dhe subjektet, apo të tretë në lidhje me persona të cilët kanë tentuar ose  
presumohet se kanë kryer krime zgjedhore. Faleminderit!

**Z. Y. Merkaj:** Di që Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka nisur një shkresë  
Prokurorisë së Përgjithshme për hetimet e deritanishme që ka bërë Prokuroria e  
Përgjithshme për krimet zgjedhore. Di që ka ardhur një përgjigje këto ditë, por nuk  
jam në dijeni të saj. Është publikuar në faqen tonë po më thotë Drejtoresha  
Juridike, por për këtë rast që po më thoni ju nuk e di.

**Znj. I. Nano:** Pra, ky informacion që është publikuar në faqe është publik, jo  
vetëm për ne por edhe për publikun. Ka ecurinë e kallzimeve penale të...

**Z. Y. Merkaj:** Për Prokurinë e Përgjithshme, prokuroritë e rretheve...

**Znj. I. Nano:** Pra, kallëzimet që janë bërë nga KQZ-ja dhe jo vetëm. Pra, për të  
gjitha kallëzimet penale për zgjedhjet e kaluara. Dakord!

**Znj. H. Vukaj:** Mund ta kemi një kopje të kësaj shkrese të prokurorisë?

**Znj. M. Koja:** Po! Patjetër.

**Znj. H. Vukaj:** Dakord, faleminderit!

**Zj. I. Nano:** Nëse nuk keni diçka tjetër kolegë, mbledhjen e deklaroj të mbyllur,  
faleminderit!

**Vendimi nr. 7**

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*

